



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 64.2 (a), nenit 87.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe Rregullën Zgjedhore Nr.10/2013 për Raundi i Dytë i Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 03.10.2017, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Caktimin e Numrit të Fletëvotimeve për Vendvotim për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave 2017

- I. Caktohet Numri i Fletëvotimeve për Vendvotim për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, që do të mbahen më 19 nëntor 2017 si në vijim:
 1. Numri i fletëvotimeve në vendvotimet e rregullta; llogaritja bëhet në atë mënyrë që për çdo vendvotim bëhet rrumbullaksimi i numrit të fletëvotimeve duke minusuar në intervalin nga -100 deri në -149.
 2. Numri i fletëvotimeve në vendvotimet e dyfishta;
 - a. Në qendrat e votimit ku ka deri në pesë vendvotime, sasia e fletëvotimeve në vendvotimin e dyfishtë shtohet duke plotësuar në intervalin nga 1 deri në 49 fletëvotime me shumë se numri i votuesve.
 - b. Në qendrat e votimit ku ka me shumë se pesë vendvotime, sasia e fletëvotimeve në vendvotimin e dyfishtë shtohet duke plotësuar në intervalin nga 51 deri në 99 fletëvotime me shumë se numri i votuesve.
 3. Numri i fletëvotimeve rezervë që shtypen kalkulohet duke rrumbullaksuar me kufirin e poshtë deri në plotësimin e dengut prej 50 fletëvotimeve, të numrit prej **5%** të votuesve për qendër të votimit. Kjo përveç në rastet kur numri i votuesve është me i vogël se 50, rrumbullakohet me numrin e fletëvotimeve në deng 50.
 4. Bazuar në Listën përfundimtare të votuesve, gjithsej votuesve me të drejtë vote për këto zgjedhje janë 1, 288.950, ndërsa do të shtypen **1,817.200** fletëvotime. Rrjedhimisht i bie që do të shtypen **73,752** fletëvotime më pak se votues apo në përqindje **-4.06 %** më pak.
 5. Bashkangjitur me këtë shkresë gjeni tabelën me informata të detajuara për secilën komunë, të rekomanduar për miratim

Prishtinë, 03.10. 2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka